



## **Statistika të pengimit të punës së gazetarëve**

Gjatë vitit 2011 në njëzet e shtatë (27) raste të ndryshme AGPK është detyruar të reagoj publikisht për shkelje të të drejtave të gazetarëve.

Prej tyre, në nëntë (9) raste të ndryshme ndaj gazetarëve është ushtruar dhunë fizike. Në shtatë (7) raste të ndryshme gazetarët janë kërcënuar. Njëri prej kërcënimeve është bërë nga një deputet i Kuvendit të Kosovës. Në tre (3) raste gazetarët dhe mediat janë fyer publikisht. Në një rast është dëmtuar prona e një gazetari. Në shtatë (7) raste tjera, AGPK ka evidentuar forma tjera të dhunimit të të drejtave të gazetarëve dhe është obliguar të reagojë.

Ka edhe shumë raste, që për shkak të kërkesave të anëtarëve asociacioni nuk ka mundur t'i publikojë. Ato janë kryesisht kampanja të thashethemeve kundër gazetarëve, dëmtime të pronave gjegjësisht të veturave të gazetarëve investigativ dhe forma tjera të pengimit të punës gjegjësisht sulmit ndaj kredibilitetit të gazetarëve.

Në vitin 2010 kanë qenë gjithsej tridhjetë e dy (32) raste kur AGPK ka reaguar. Ndonëse numri i rasteve të këtij viti është më i vogël, serioziteti i tyre është më i madh. Shumica absolute e rasteve të vitit 2010, kanë qenë kërcënime, derisa shumica e rasteve të këtij viti janë sulme fizike ndaj gazetarëve.